

## SPECIFIKIMET E GAZIT TË LËNGSHËM PËR SOBA GATIMI

1- Gazi i Lënget duhet te përmbajë standartin evropian **Propan dhe Butan ISO 9162:2013**

Treguesit	Njësia e matjes	Limitet	Propani tregëtar	Butani tregëtar	Metoda testuese
Densiteti në 15 °C	kg/m <sup>3</sup>		raport	raport	ISO 8973 ISO 3993
Madhësia e tensionit të avujve	kPa	max	1550 a	520 a	ISO 4256 ISO 8973
Hidrokarburet C <sub>2</sub> Hidrokarburet C <sub>4</sub> Hidrokarburet C <sub>5</sub>	% molare % molare % molare	max max	Raport 7.5 0.2	- - 2.5	ISO 7941
Hidrokarburet e pangopura	% molare		Raport	Raport	ISO 7941
Dienet	% molare	max	0.5	0.5	ISO 7941
Mbetja mbas avullimit	mg/kg	max	60	60	EN 15470 EN 15471 EN 16423
Korrozioni në bakër		max	1	1	ISO 6251
Squfuri	mg/kg	max	50	50	ASTM D 6667
Sulfuri i hidrogjenit			negativ	negativ	ISO 8819
Përmbajtja e ujit të lirë			mungon	mungon	

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet

të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

- 1.1 Gazi i Lëngët (GLN) duhet të respektojë kërkesat e standardit evropian S SH EN 589:2018 “Lëndë djegëse për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë) i cili përmbush plotësisht kërkesat e cilësisë sipas shtojcës 4 të VKM nr 429 dt 26.06.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si edhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, si edhe ***Sipas Drejtorisë së Standartizimeve.***
- 1.2 Raporti në funksion të stinës i gazit të lëngshëm nuk duhet të ketë ndotës të squfurit dhe gazra shoqëruese të tij dhe praktikisht, në verë përdoret mishelë (butan+propan), në dimër propan.
- 1.3 Bombolat të plotësojnë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara sipas rregullit teknik përkatës, përfshirë edhe pajisjen e tyre me **deklaratën e konformitetit**, si dhe me numrin e serisë. Bombola duhet të mbartë markimin përkatës, që demonstroi përputhshmërinë e saj me kërkesat e legjislacionit në fuqi për konformitetin.
- 1.4 Në sipërfaqen e bombolës duhet të pasqyrohen
  - të dhëna për markën tregtare të shoqërisë,
  - peshën neto dhe bruto, të shprehur në kilogram
  - simbolin e flakës së ndezshme
  - vitin e prodhimit
  - datën e kontrollit teknik
  - udhëzimin për përdorim të sigurt të tyre.
- 1.5 Bombolat me të cilat do të transportohet GLN duhet të plotësojnë standardet e kërkuara nga ***Inspektoriat Shtetëror teknik dhe Industrial.***
- 1.6 Bombolat duhet të jenë të testuara edhe për mos shpërthimin e tyre në rast zjarri.
- 1.7 Ambalazhimi i gazit duhet të bëhet në bombola me kapacitet jo më shumë se 10-25 kg.
- 1.8 Bombolat duhet të jenë të pajisura me çertifikatë origjine dhe skedat teknike të tyre.
- 1.9 Bombolat duhet të kenë të stampuar në trup treguesit e vëllimit të enës, peshës bosh të saj, si dhe datën kur është prodhuar.
- 1.10 Bombulat sigurohen nga Operatori Ekonomik fitues dhe montohen në guzhinat e kopshteve dhe çerdheve nga punonjësit e Kontraktorit
- 1.11 Bombulat duhet të kenë të stampuar në trup një numër serie me jo më pak se 6 shifra, në mënyrë që të jenë të identifikueshme nga njera-tjetra.

## SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

### - Sasia e mallit që kërkohet, afërsisht 27.169 litra

Grafiku i lëvrimit do të jetë sipas kërkesave të AK, në varësi të nevojave të kopshteve çerdheve dhe konvikteve.

### Afatet dhe kushtet e lëvrimit:

1. Sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundim të periudhës 12 mujore dhe të mbarimit të sasisë.
2. Porositë e gazit do t'i jepen operatorit furnizues gjatë javës me telefon nga sektori i administrimit Qendrës Ekonomike të Arsimit një ditë përpara furnizimit. Furnizimi do bëhet me bombola sipas kapaciteteve të poshtëshënuara të cilat duhet të jenë të subjektit. Bombulat të jenë të kolauduara me vulën përkatëse ku të jetë shënuar edhe pesha bruto dhe neto e bombulës. E shtuna dhe e diela është pushim.

*Argumentim:* Kjo për arsye se pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit vijnë kërkesat nga Kopshtet Çerdhet dhe Konviktet në varësi.

3. Bombolat e porositura nga sektori i administrimit duhet të vijnë në magazinën e Qendres Ekonomike te Arsimit me automjetet e operatorit furnizues dhe shpërndarja do të bëhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

*Argumentim:* Qëllimi është shpërndarja Brenda orarit për shkak të shtrirjes territoriale të Institucioneve të varësisë( kopshte, çerdhe, konvikte)

Lista e Institucioneve të Qendrës Ekonomike të Arsimit që do të furnizohen me gaz për gatim

N R	KOPSHTET
1	1 MAJ
2	1 QERSHORI
3	7 MARS
4	SOTIR NOKA
5	SOROS
6	FIDANISHTE
7	FOTOMONO BEU
8	MET HASA
9	NEIM BABAMETO
10	HASAN KOCI
11	NJAZI MASTORI (Sukth)
12	RREZE DRITE (Manzë)
13	ISUF FERRA

N R	CERDHE
1	CERDHE NR:1
2	CERDHE NR:2
3	CERDHE NR:3
4	CERDHE NR:4
5	CERDHE NR:5
6	CERDHE NR:6

N R	KONVIKTET
1	KONVIKTI : BEQIR CELA
2	KONVIKTI : B. QERAXHIA

4. Me ardhjen e bombolave të porositura, komisioni i pritjes së Gazit të Lëngshëm do të kryejë verifikimin e cilësisë në bazë të specifikimeve teknike si dhe sasinë e gazit të ardhur duke peshuar çdo bombul.

**Argumentim:** Qëllimi është shmangia e problemeve përsa i përket sasisë së mallit të prokuruar.

5. Çdo furnizim me gaz të lëngshëm duhet të shoqërohet me fletë-analizën përkatëse, të lëshuar nga laboratorit i analizave të I.Q.T.

**Argumentim:** Qëllimi është shmangia e problemeve përsa i përket cilësisë së mallit të prokuruar.

6. Ambalazhimi i gazit do të bëhet me bombula me kapacitet 10 kg , 15 kg , 20 dhe 25 kg. Bombulat sigurohen nga firma furnizuese fituese dhe duhet të jenë të testuara për sigurinë e tyre. Ato duhet të shoqërohen me dokumentacionin e testimin të tyre dhe me vulat ose marketimet përkatëse, të lëshuara nga institucionet përkatëse , në përputhje me legjislacionin në fuqi për enët nën presion. Pas procedurave të mësipërme, bombolat e gazit do të shpërndahen nëpër çerdhet dhe kopshtet me automjetet e operatorit furnizues duke u shoqëruar nga një punonjës i caktuar si kontrollor nga DPÇK, deri në dorëzimin dhe vendosjen (montimin) e bombolës në vendin e duhur nga punonjësi i subjektit kontraktor i cili është i pajisur me certifikate profesionale të vlefshme për instalimin e bombolave të gazit.

**Argumentim:** Kjo për shkak të instalimeve që disponohen nga Institucionet tona të varësisë( kopshte, çerdhe, konvikte), si edhe garantimin e sigurisë së tyre gjatë përdorimit të bombulave.

7. Operatori furnizues duhet t'i dorëzojë çdo kopshti apo çerdhje nga 2 deri në 5 bombula të cilat merren në dorëzim nga drejtoresha, kuzhinierja dhe nd/kuzhinierja.
8. Montimi dhe çmontimi i bombolave është detyrë e operatorit furnizues për t'i ndërruar ato.
9. Operatori furnizues pas lidhjes së kontratës është i detyruar të ndërrojë reduktorët dhe tubat e presionit nga bombola deri tek soba e gatimit, në të gjitha kopshtet dhe çerdhet publike të cilat përdorin soba me gaz, sipas nevojave që kanë. Operatori është përgjegjës për rregullimin dhe mirëmbajtjen e këtyre aksesorëve.
10. Shpërndarja e bombulave të gazit dhe kostoja e transportit deri në Kopshte dhe Çerdhe do të mbulohet nga Operatori Ekonomik.
11. Përzierja e gazit duhet të jetë përzierje e hidrokarbureve të gazeve propan 50% dhe butan 50 % , me erën karakteristike të tij dhe gjatë djegies krijon një flakë ngjyrë qielli në blu.

## **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Argumentim mbi hartimin e specifikimeve teknike të gazit të lëngët dhe hartimin e kritereve teknike për kualifikim.**

Për hartimin e specifikimeve teknike të Gazit të Lëngët për gatim dhe hartimin e kriterëve teknike për kualifikim, komisioni i është referuar:

*Në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Gjithashtu i është referuar :*

- *Standartit Shqiptar SSH EN 589;2018 "Lëndë djegëse për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)*
- *Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 429 dt 26.06.2019 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si edhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)"*
- *Vendimit Nr. 212 datë 16.03.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombulave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN".  
Ligjit 10489/2011 "Për mbikqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore", i ndryshuar.  
VKM Nr. 1047 date 16.07.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 170 datë 25.04.2002 të Këshillit të Ministrave" , "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve dhe të autorizimeve, për tregëtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.  
Ligjin Nr.9902, date 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar  
Ligjit Nr. 32/2016 "Për sigurinë e punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion".  
Urdhrin Nr. 128, date 08.04.2016 "Për miratimin e procedurave për kontrollin teknik të vlerësimit të konformitetit të bombulave të GLN".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

### **Grupi i Specifikimeve Teknike**

- |                  |         |
|------------------|---------|
| 1.Megi Grami     | Kryetar |
| 2.Eriona Beshiri | Anëtar  |
| 3.Arben Dalipaj  | Anëtar  |